

VENDIM
Nr. 788, datë 14.11.2012

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË GRANTIT NR. TF 012148, TË FONDIT TË
MIRËBESIMIT TË SHUMË DHURUESVE, NDËRMJET SHQIPËRISË DHE BANKËS
NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (IBRD), QË VEPRON SI
ADMINISTRATORE E KËTIJ FONDI, PËR FINANCIMIN E FAZËS SË DYTË TË MBËSHTETJES
PËR ZBATIMIN E NISMËS PËR TRANSPARENCË NË INDUSTRIË NXJERRËSE NË SHQIPËRI
(EITI)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së grantit nr. TF 012148 të Fondit të Mirëbesimit të Shumë Dhuruesve, ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), që vepron si administratore e këtij fondi, për financimin e fazës së dytë të mbështetjes për zbatimin e nismës për transparencë në industrinë nxjerrëse në Shqipëri (EITI).

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha